

Shkollat efektive janë komunitete që mësojnë (që zhvillohen profesionalisht)

Elementët thelbësore të komuniteteve që mësojnë:

- Kultura e bashkëpunimit
- Kultura e përgjegjësise kolektive
- Nuk ndihmojë thjesht në zhvillimin individual të emsuesve por në këmbimin e eksperiencës me qëllim që të ëprfitojnë komuniteti I shkolëls dhe të plotësohet vizioni dhe qëllimet e komunitetit
- Lejojnë debatet mes anëtarëve të tij lidhur me problem të ndryshme të të mësuarit
- Marrin parasysh që mësuaesit janë individë të rritur të cilët mësojnë në mënyra të ndryshme, që punojnë në kontekste të ndryshme , kanë formim të ndryshëm dhe u japin mësim nxënësve që kanë nevoja diverse (Me fjalë të tjera nmësuesit kanë nevoja të ndryshme individuale, motive të ndrsyhme për zhvillimin profesional, dije dhe eksperiencë të mëparshme)
- Mësuesi mund të zhvillohet individualisht nga pikëpamja profesionale por kjo që ai mëson mund të mos ndahet me të tjerët, ndërsa në rastin e punës në ekip bashkëpunimi dhe shkëmbimi I asaj që mësohet është një normë dhe në nivel shkolle..

Ekipet e të mësuarit professional (zhvillimit profesional)

- Janë një mënyrë efektive për të zhvilluar një kulturën bashkëpunimi dhe përgjegjësie kolektive në shkollë
- Mësuesit në përbërje të këtyre ekipe mbajnë përgjegjësi për nxënësit specifikë që ata u japin mësim, por njëkohëshit mbajnë një përgjegjësi kolektive për përimiërsimin e praktikave, të mësimdhënies që ndihmojnë në arritjen e rezultateve për gjithë nxënësit në shkollë
- Kërkesa për mësuesit në përbërje te ekipit: të qënit I hapur, të qënit kritik, aftësia për të reflektuar, aftësia për të ndarë eksperiencat mendimet me të tjerët dhe përfshirjen në një process të vazhdueshëm studimi që shpie më në fund në një mësuar të thellë
- Puna e ekipeve drejtohet nga një model i qartë dhe sistematik i zgjidhjes së problemeve dhe të mësuarit që përfshin një cikël : 1. të mësuarit - 2. aplikimi I asaj që është mësuar- 3. modifikimi I asaj që është mësuar dhe përsëri 4. zbatim në procesin mësimor I asaj që ëshët mësuar dhe modifikuar.
- Mësuesit në ekip përdorin informacion të bazuar në kërkimet shkencore që të mësojnë strategji të mësimdhënies në përputhje me stilet e të mësuarit të nxënësve
- Grumbullojnë dhe analizojnë të dhënat me rezultatet e nxënësve për të përcaktuar se ku të përqëndrohen në lidhje me përmbajtjen e zhvillimit të tyre profesional dhe po ashtu mbledhin të dhëna për mësuesit për të vlerësuar impaktin e e puëns së tyre në përparimin e nxënësve në nivel shkolle.

- Mblidhen rregullisht për një periudhë të zgjatur kohe me qëllim që të kenë mundësi të mësojnë, reflektojnë, përmirësojnë dhe riaplikojnë atë që kanë

Vështirësi të punë në ekip

- Rritet mbinkarkesa e mësuesve sidomos në fillimet e punës në ekip për arsye se atyre u duhet kohë që të mësojnë sesi të punojnë në ekip
- Zhvillimi i besimit dhe konfidencës për të ndërmarrë rreziqe (për të ndërmarrë inisiativa) kërkon durim sepse puna në ekip ëshët në konflikt me autonominë që ka karakterizuar punën e mësuesve historikisht

Drejtimi i ekipi të ZHP

- Drejtuesi duhet të dijë mënyrat dhe kërkesat e punës në ekip
- Drejtuesi vepron në rolin e mentorit; modelon praktikën e mirë; ndihmon me sigurimin e materialeve dhe lehtëson dhe bën të mundur që anëtarët e ekipit të kenë në dispozicion kërkesat shkencore lidhur me mësimdhënien dhe të mësuarit efektiv.
- Organizojnë vizita në shkolla të tjera për të vëzhguar praktika inovative' lehtësojnë aktivitetet problem zgjidhëse; inkurajojnë ndërmarrjen e iniciativave , lidhin anëtarët e ekipit me njëri tjetrin; kontaktojnë ekspertë të jashtëm e risk-taking; aplikojnë për projekte
- Vlerësojnë impaktin e zhvillimit profesional të punës në ekip në dijet dhe shprehitë e mësuesve në praktikën e klasës dhe në rezultatet e nxënësve.
- Duhet të kuptojnë dhe implembentojn ë modelet e zhvillimit profesional efektiv.

Modelet e zhvillimit profesional në punën në ekip

- Duhet përputhur modeli i zhvillimit profesional që do të përdoret me qëllimin e programit të zhvillimit profesional që do të përdoret
- Përshtatshmëria e secilit model varion në varësi të qëllimeve, përmbajtjes dhe kontekstit të implementimit.

Kërkimi shkencor i aplikuar në praktikën e përditshme

- Strategji që të lejon të mësosh për procession e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Mësuesit përcaktojnë pyetjet që janë të rëndësishme për të ekzaminuar me qëllim që ata të kuptojnë se çfarë po ndodh në klasat e tyre.
- Pastaj fokusohen , mbledhin analizojnë dhe intgerpretojnë të dhanët dhe ndërm,arri një veprim..
- Modeli bazhet në besimin e mësuesit kanë aftësinë që të formulojnë pyetje me vlerë lidhur me praktikën etyre dhe tu japin përgjigje këtyre pyetjeve.

- Ndhmon mësuesit të bëhen më efektivë dhe zgjidhës problemash sistematikë.

Ekzaminimi I punës së nxënësve

- Ekzaminimi kolektiv I punës së nxënësve e aftëson mësuesit të kuptojnë sesi mendon nxënësi, gjë që i lejon ata të ëpridoren strategji dhe materialet në mënyrë të duhur.
- Në fillim ekipi përcakton një fokus të qartë për punën e tij dhe se çfarë prëti si ëprfundim nga kjo punë.
- Mund të organizohen diskutime materiale të shkruara nga disa nxënës në lidhje me të njëjtat detyra që përfshijnë kërkesën që nxënësit të shprehin mendimin e tyre lidhur me një çështje.
- Ekipi reflekton lidhur me të që ëshët mësuar si pasojë e kësaj pune për ta zbatuar ën procesin e mësim dhënies. Diskutimet mund të theksojnë mënyrat në të cilat mësuesit mund të përmirësojnë mësimdhënien e tyre bazuar në atë që ata kanë mësuar lidhur me faktin sesi nxënësit kanë kuptuar konceptet që janë përfshirë ën detyrë.

Grupet e studimit

- Grupet e studimit përfshihen regullisht në ndërveprime bashkëpunimi në lidhje me çështjet që janë identifikuar nga nxënësit.. Kjo lejon që të reflektojnë në praktikat e klasës dhe të analizojnë të dhënat për të ëmsuarit të nxënësve.
- Grupet mund të lexojnë dhe diskutojnë publikime të kërkimeve në fushën e arsimit në një mjedis suportiv dhe bashkëpunues , gajtë një eriidhe të zgjatur kohore.
- Modeli I grupeve të studimit mund të ëprfshijë gjithë stafin e shkollës për të gjetur një zgjidhje për problemet e përbashkëta
- Krijohen më pas mundësit që grupet të komunikojnë gjetjet e punës së tyre dhe rekomandimet të ët gjithë kolegët e tjerë.
- Mësuesit bashkëpunojnë si një grup i vetëm I madh ose në ekipe më të vogla për të studiuar një problem të përbashkët ose për të hartuar dhe zbatuar një plan për të arritur një qëllim të përbashkët. Studimi—leximi, diskutimi, shkrimi dhe reflektimi , I udhëhequr nga një moderator (facilitator) me ekpseriencë, ëshët komponenti kyç I një grupi studimit. Gjatë studimit në grup mund të përdoren materiale të printuara, materiale të punës në klasë (të krijuara nga nxënësit) si dhe përvojën e tyre që lidhet me problemin që studiohet.

Diskutimet e rasteve

- I japin mundësi ekipeve të mësuesve të reflektojnë mbi mësimdhënien dhe të mësuarit e nxënësve duke ekzaminuar histori narrative ose video për të mësuarit që ndodh në klasë, shkollë , situatë dhe dilemme situacionale të të mësuarit.
- Këto janë të shkurtra, faktike lidhur me atë që nxënësit kanë bërë, aknë thënë dhe kanë shkruar në klasë.

- Diskutimet e rasteve bëjnë të mundur dialogjet reflective dhe përmirësojnë aftësinë e mësuesve që të përshkruajnë, analizojnë dhe vlerësojnë punën e tyre..

Vëzhgimi i orëve mësimore të mësuesve kolegë

- Një nga mënyrat më të mira për të mësuar është vëzhgimi i të tjerëve, ose të vëzhgohesh nga të tjerat dhe të jepet informacioni i ndërsjellë specifik në lidhje me atë që është vëzhguar. Analysing and reflecting on this information can be a valuable means. Analizimi dhe reflektimi mbi këtë informacion që përftohet nga vëzhgimi është një mënyrë mjaft e vlefshme për tu rritur profesionalisht.
- Vëzhgimet më efektive janë të mirëplanifikuara, të fokusuara në një çështje specifike dhe me diskutim më pas, rreth asaj që është diskutuar me qëllim që të përmirësohet mësimdhënia.
- Vëzhgimi i mësimit të mësuesve kolegë promovon një mjedis të hapur i cili stimulon në diskutim publik.
- Në këtë model një mësues me shumë eksperiencë në shkollë ose një specialist vëzhgon mësuesit në klasën e tyre, vlerësojnë praktikën e tyre të mësimdhënies dhe japin një feedback të strukturuar. Ky model i ZHP mund të përdoret si një mbështetje pas seminareve ose në mënyrë periodike gjat vitit shkollor si një formë e mentorimit të mësuesve.

Studimi për përgatitjen e ditareve (leksionin e orëve mësimore)

- Ky model i ZHP i ndihmon mësuesit që të përgatisin një plan mësimi (leksioni mësimor) dhe të kuptojnë më thellë sesi nxënësit mësojnë njohuri nga lëndë specifike. Një grup i vogël mësuesish takohen në mënyrë të rregullt për të planifikuar, skicuar, zbatuar, vlerësuar dhe përmirësuar leksionet për një grup njohurish lëndore. Një anëtar i grupit jep mësimin ndërsa anëtarët e tjerë vëzhgojnë. Pastaj bazuar në vëzhgimet dhe reflektimet e tyre mësuesit modifikojnë leksionin mësimor dhe mund të jepet mësim më pas nga një anëtar tjetër i grupit. Pastaj mbledhi të dhëna për të parë se çfarë impakti ka ky leksion në përparimin e nxënësit. Kjo ndodh për një periudhë disa mujore.
- Qëllimi i këtij modeli është të promovojë një proces ku mësuesit përjetojnë një rritje graduale profesionale përmes një zhvillimi në bashkëpunim të një leksioni (për një orë mësimore).
- Ky model është shumë intensiv kërkon shumë kohë dhe kërkon që mësuesit të kenë shprehur themelore në të gjitha aspektet e të mësuarit.

Rrugë të tjera për t'u zhvilluar profesionalisht në komunitetet që mësojnë. (komunitetet mësimore)

- **Biseda të përditshme** me mësuesit e tjerë në sallën e mësuesve ku mësuesit ndajën eksperiencat e tyre për praktikën e të mësuarit, stilet e të mësuarit të nxënësve të ndryshëm, teknikat e reja të

vlerësimi , teknikat e menaxhimit të klasës Këto ndërveprime informale përbëjnë një formë të rëndësishme të suportit kolegjal dhe të mësuarit për mësuesit..

- **Mentorimi i strukturuar.** Ky model lejon që mësues më me eksperiencë të bëhen çift me mësues me më pak eksperiencë ose me mësues fillestarë me qëllim që të shërbejnë si modele të roleve profesionale dhe të promovojnë dialogun profesional.
- **Të mësuarit në çift (Coaching)** është një formë e të mësuarit që përfshin dy mësues me eksperiencë që punojnë e mësojnë së bashku . Kjo mënyrë e zhvillimit profesionale është shumë e rëndësishme sepse mund ti ndihmojë mësuesit që të zbatojnë ndryshime të rëndësishme në klasën që japin mësim, psh të zbatojnë një strategji të re të mësimdhënies.
- **Ekspertët e ftuar nga jashtë shkollës.** Për të punuar me mësues të veçantë ose me ekipet profesionale të mësuesve.
- **Seminaret dhe wëorkshopet, ndjekja e kurseve.** Këto forma janë të rëndësishme kur kur mësuesit kanë nevojë të mësojnë shprehje dhe dije specifike, si psh njohuri të thelluar ëpr lëndët që japin mësim. Në rastet kur mësuesit e një shkolle ndjekin këto forma jashtë shkollës duhet që të gjëndet një mekanizëm që këto njohuri dhe shprehje që përftohen nga këto aktivitetet jashtë shkollës të ndahen me mësues të tjerë të shkollës.